



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 11.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NPSH Bageri" për aktivitetin: "Rekonstruimi i rrugës "Haxhi Zeka" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-4672-521 nxjerr:

## V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "NPSH Bageri" e datës 09.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit : "Rekonstruimi i rrugës "Haxhi Zeka" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-4672-521.

Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj tutje me *kete aktivitet*.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NPSH Bageri" me datë 09.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rekonstruimi i rrugës "Haxhi Zeka " dhe me numër të prokurimit: 616 -20-4672-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.11.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE-ik "NPSH Bageri" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rekonstruimi i rrugës "Haxhi Zeka " dhe me numër të prokurimit: 616 -20-4672-521.

-Pretendimi juaj se nuk keni ndryshuar asgjë ne përshkrimin e çmimit eshte i pa bazuar,pasi qe ju ne ate përshkrim eshte dashtë vetëm te vendosni çmimet tuaja e jo te ndryshoni sasi të e paarqitura.Ua përkujojme se përshkrimi i çmimit eshte nje nga formularët standard te tenderit dhe sipas nenit 45.3 te RRUOPP-se,operatori ekonomik përveç Logos nuk ka te drejtë te beje asnjë ndryshim ne përmbajtjen e këtij dokumenti.

Lidhur me kete do ta keni te bashkëngjitur edhe interpretimin e KRPP-se.

Bazuar ne sqarimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

# FW: Pershendetje

Prokurimi Prishtine

Fri 10/23/2020 1:30 PM

To: Aferdita Hasimi <aferdita.hasimi@rks-gov.net>; Ylber Jashari <Ylber.Jashari@rks-gov.net>;

Cc: Zeke Bardhaj <Zeke.Bardhaj@rks-gov.net>; Shqipe Isufi <Shqipe.Isufi@rks-gov.net>;

Te nderuar ,

Gjeni te bashkangjitur interpretimin e KRPP-se.

Me respekt Departamenti I Prokurimit

---

**From:** Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>

**Sent:** 23 October, 2020 12:23

**To:** Prokurimi Prishtine <prokurimi.prishtine@rks-gov.net>

**Subject:** Re: Pershendetje

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor, si në vijim:

**Pjesa II e Formularit të Tenderit "Përshkrimi i çmimit"** është formë standarde e Dosjes së Tenderit, i cili duhet të plotësohet nga Operatori Ekonomik ashtu siç është specifikuar nga Autoriteti Kontraktues dhe në përputhje me nenin 45.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Operatori Ekonomik përveç Logo-s nuk ka të drejtë të bëjë asnjë ndryshim në përmbajtjen e këtij dokumenti.

Sipas nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të LPP-së, në funksion të KRPP-së është " t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP".

**Sipas nenit 59 të LPP-së, vlerësimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.**

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, "**Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".**

Sipas nenit 87 të LPP-së, KRPP është in-kompetente të bëjë vlerësimin e tenderëve, prandaj iu këshillohet t'i vlerësoni tenderët në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e tenderit (Dosjen e Tenderit , Njoftimin për Kontratë) dhe të merrni një vendim në nënputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP

11/11/2020

FW: Pershendetje - Zeke Bardhaj

Me respekt,  
Arbnora Cakolli-Luzha,  
Kordinatore e Departamentit të Rregullave-KRPP.

\*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*

Vërejtje: *Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe assesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit.*

---

**From:** Prokurimi Prishtine  
**Sent:** Thursday, October 15, 2020 1:36 PM  
**To:** Rregullat Krpp  
**Cc:** Zeke Bardhaj  
**Subject:** Pershendetje

Te nderuar,

Ne nje aktivitet te prokurimit kemi pranuar oferta ne cilat disa OE-ik kane nderhyre ne paramase dhe parallogari dhe kane ndryshuar sasite. Me konkretisht ka ndryshuar sasine ne dy pozicione dhe ate si vijon :

- Ne njerin pozicion ka qene sasia e parapare 14 ,782 m<sup>2</sup> ndersa OE-ik e ka ndryshuar dhe paraqitur sasine 14.781,50 m<sup>2</sup>
- Ne pozicionin tjeter ka qene sasia e parapare 1,477 m<sup>2</sup> ndersa OE-ik e ka ndryshuar dhe paraqitur sasine 1,476.50 m<sup>2</sup> .

Pyetja jone eshte : A mund te pranohen ofertat e tyre si te pergjegjeshme apo duhet refuzuar.

Me respekt Departamenti I Prokurimit